

VENDIM
Nr.294, datë 28.4.2010

**PËR DHËNIEN NË HUAPËRDORJE DELEGACIONIT ITALIAN TË EKSPERTËVE
(DIE), NË TIRANË, TË DISA ZYRAVE NË NDËRTESEN E MINISTRISË SË
MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 901 e në vijim të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar, dhe të nenit 9 të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Italisë, nënshkruar nga palët më 18 shtator 2009, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Dhënien në huapërdorje delegacionit italian të ekspertëve (DIE), në Tiranë, të disa zyrave, me sipërfaqe trualli, gjithsej, 266 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) m², në ndërtesën e Ministrisë së Mbrojtjes.

2.Afati i kontratës së huapërdorjes të jetë 3 (tre) vjet, me të drejtë ripërsëritjeje.

3.Autorizohet Ministria e Mbrojtjes të lidhë marrëveshjen teknike për kalimin, kushtet, të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe për përcaktimin e këtyre mjediseve.

4.Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha